



Tel & Fax: +355 4 22 23 546 / 4 22 24 993 email: elona@jona-travel.com  
**NEVER CHANGE A WINNING TEAM**



### **PARIS – MUNICH : 26 – 30 JANAR**

**Dita e parë.** Udhëtimi me avion për në Paris. Pritja në Aeroportin Charles de Gaulle. Eskursion Parisi Naten, ku do të behet një shetitje me autobus në qendër të qytetit dhe përgjatë Senes. **Ora 21.00 shetitje me anije në lumen e Senes**



(Bileta e përfshirë). Ky udhëtim zgjat rreth 1 orë, ku do të shikoni të gjitha objektet historike që shtrihen përgjatë senes dhe do të degjoni nga guida detajet historike për urat përgjatë lumit. Mbas shetitjes me anije ora 22.00 kthim në hotel me metro.

**Dita e dytë,** Pas mëngjesit në hotel nisja me autobus ne: **Ekskursioni “Parisi gjatë ditës dhe vizite e objekteve me të njohur”** me autobus dhe guide në shqip ku do të vizitohen: Katedralen Notre Dame, Sheshi La Concorde, Muzeun e Luvrit (nga jashtë), Bulevardi Champs Elysees, Kullen Eifel, Trocadero, Harkun e Triumfit, Muzeumi I Veteraneve të luftës, dhe përfundon në Katedralen e Parisit.



Në këtë tour autobosi ndalon 30 – 45 min në çdo objekt për ta vizituar nga jashtë dhe për të bërë fotografi. Gjithashtu guida shpjegon historikun e çdo objekti fakte interesante dhe vlerat e tyre. Ky tour fillon në orën 09.30 dhe mbaron 13.30 në drekë. Gjatë këtij ekskursioni nuk mjafton koha për të hyrur në kullen Eifel. (Diskutohet me drejtuesin e grupit për një moment tjetër). Mbas mbarimit të ekskursionit autobosi na ndalon në Lagjen Latine për të ngrene drekën ku ka restorante të të gjitha llojeve dhe fast foode me cmime të ndryshme. Mbas Drekes orë 15.30 do të vizitojmë **Muzeun e Luvrit** i cili ndodhet fare pranë Lagjes Latine. 19.00 Mbas Muzeut vajtje me auto në drejtim të **Kulles Eifel** (Bileta e hyrjes deri në kat të tretë 13 Eur). Sado që shumë prej jush mund ta kenë vizituar këtë kullë ajo është gjithmone si një spektakel modern, efekte dritash të kombinuara me një muzikë moderne.

**Dita e tretë,** Mëngjesi në Hotel. Dite e lire ose program opsional- Vizite në Pallatin e Versajes ose Disneyland Paris. Në mbremje transfera për në aeroport dhe nisja drejt Munich. Mberritja dhe transfera për në hotel . Akomodimi.

**Dita e katërt,** Mengjesi ne Hotel. Ekskursion me guide profesionale ne Munich. Do të keni mundesin t'a shijoni shetitjen me autobus të hapur dykatësh duke vizituar pikat kryesore të qytetit të Munich-ut.

Gjatë shetitjes , do të vizitohet Pallatin Nymphenburg (ndërtuar në vitin 1675) me kopshtet Royal, Amalienburg , botanik dhe muzeun. Pallati ka qenë vendbanim i mbretërive bavareze.

Më pas, nën drejtimin e guides do të zbulojmë Munichun modern dhe bashkëkohor, duke vizituar terrenet Olimpikë, ku do të gjejmë atraksionet si akvariumin Sea Life , stadiumin Olimpik, kullen Olimpikë. Do të shijoni pamje fantastike dhe panoramike nga një lartësi prej 290 m nga kulla Olimpikë. Më pas, vizitë në muzeun e BMW dhe botën e makinave të reja BMW.

Vizita do të vazhdojë në qarkun Schwabing (pjesën veriore të Munichut) historikisht e njohur si “lagje e artisteve”, ku do të shëtisim përgjatë rrugës Leopold. Rruga Leopold ndan qarkun Schwabing në dy pjesë : lindje dhe perëndim. Përgjatë rrugës Leopold , do të kemi mundesi të shohim një nga monumentet më të famshme të Munich-ut “ Walking Man”. Parkun e madh “English Garden” , i cili shtrihet përgjatë lumit Isar.Mbremje e lire.



**Dita e peste,** Mengjesi ne Hotel.Kohe e lire.Transferimi për në Aeroport. Udhëtim me avion për në Tiranë.

**Çmimi për person Dhomë Dyshe 549 Euro**

**Përfshihen ne cmim:**

1. Udhëtimi vajtje-ardhje me avion
2. Transfertat dhe shëtitjet me autobus sipas programit
3. Akomodim në hotel 2 nete ne Paris dhe 2 nete ne Munich
4. Mëngjeset për të gjitha ditët e udhëtimit.
5. Lundrimi me Anije.
6. Shoqërues shqiptar gjatë qëndrimit jashtë Shqipërisë.
7. Siguracioni shendetesor

**Nuk perfshihen ne cmim:**

1. Gjithshka që nuk është përmendur në këtë program.
2. Programet Opsionale.
3. Hyrjet në monumente dhe muzeume.